



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 258, datë 30.12.2019¹

PËR
DHËNIEN E PËLQIMIT PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË EMETIMIT
DHE PRODHIMIT TË POLICËS SË SIGURIMIT KUFITAR

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 14, pika 3, të Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010 “Për standartet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Dhënien e pëlqimit për fillimin e procedurave për emetimin dhe prodhimin e policës së sigurimit kufitar sipas specimenit miratuar me vendimin e Asamblesë së Anëtarëve të BSHS, nr. 20, datë 05.11.2019, me ndryshimet sa më poshtë:
 - Të identifikohet shoqëria e sigurimit me logon përkatëse, përfshirë emrin e plotë të shoqërisë, adresën e shoqërisë dhe selisë qendrore të degës, nëpërmjet së cilës bëhet nënshkrimi i kontratës së sigurimit.
2. Kontrata e sigurimit të përmbajë elementin e sigurisë të njëjtë me policat e sigurimit të detyrueshëm motorik TPL, të emetuara nga B.SH.S.
3. Vendimi i Bordit nr. 55, datë 21.06.2013 “Për dhënien e pëlqimit për fillimin e procedurave të emetimit dhe prodhimin të policës së sigurimit kufitar”, shfuqizohet.
4. Ngarkohet Byroja Shqiptare e Sigurimit dhe Departamentet përkatëse të Autoritetit për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Ervin METE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI

¹ Shfuqizuar me vendimin e Bordit nr. 86, datë 31.05.2021